STS-PSA-INFO

SCHWEIZER TIERSCHUTZ STS · PROTECTION SUISSE DES ANIMAUX PSA · PROTEZIONE SVIZZERA DEGLI ANIMALI PSA

Katzen / Chats / Gatti
Albanisch / Albanais / Albanese

Fletë udhëzuese mbajtja e maceve

Jeta mesatare: deri 20 vjet.

Shpenzimet

Kafsha	300-2000 CHF	Varësisht nga raca dhe origjina
Shpenzimet fillestare	500-1000 CHF	Enë për ushqim dhe ujë, dru gërvishtës, WC për mace pajisje tjera (derë për mace dhe të ngjashme), shpenzimet e veterinerit për tredhje (kastrim), vaksinimet, heqje të krimbave
Shpenzime vjetore	afër 1000 CHF	Ushqim, shtrojë për mace, shpenzimet e rregullta veterinere për heqjen e krimbave, qëndrim në pansion për mace gjatë pushimeve
Të tjera	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta tejkalojnë shumë çmimin e blerjes së kafshës.	

Mace race ose mace shtëpie?

Mbajtësit e ardhshëm të maceve duhet të informohen mire tek specialistët dhe në literaturën e lëmisë përkatëse para se të vendosin për mbajtjen e maceve. Macet race dhe macet shtëpiake nuk dallohen shumë nga njëra-tjetra. Disa raca janë diçka më aktive dhe me të zëshme (siameze), të tjerat diçka më të qeta (persiane), mirëpo edhe ndërmjet maceve shtëpiake ka shumë karaktere të ndryshme, prej kafshës së llastuar deri tek lojtari aktiv ose tek macja e flaktë për pavarësi. Macet race mund të jenë të mbikultivuara. Pasojat janë problemet shëndetësore. Macet me qime të gjata shpesh, siç janë macet persiane, shpeshherë nuk mund ta mirëmbajnë vetë leshin e tyre, ndaj edhe ai bëhet nyje. Ato duhet çdo ditë të krehën furçë, gjë që shumica e tyre nuk e tolerojnë.

Mace e re ose mace e rritur? Maçok apo mace?

Macet e reja janë lozonjare, ndërsa në ketë pikëpamje macet e rritura karakteri i tyre është mësa i formuar. Pasi që preferohet që të gjitha macet prej moshës 6 muajsh të tridhen (kastrohen), gjinia e tyre nuk është dominante në zgjedhje dhe shpeshherë zgjedhja e tyre varet (mbulohet) nga ndryshimet ne karakterin e tyre.

Ku mund të blihen? Çka të merret parasysh?

Shumë mace të këndshme, të reja dhe të rritura, presin një vatër të re në shtëpitë për kujdesjen e kafshëve të braktisura të organizatave për mbrojtjen e kafshëve. Personeli i shtëpive për kujdesjen e kafshëve të braktisura, i këshillon pronarët ardhshëm të maceve në mënyrë kompetente. Shumica e shtëpive japin vetëm mace të vaksinuara, të mjekuara kundër parazitëve dhe të tredhura me pagesën e një kontributi të veçantë dhe me një kontratë. Nëse është një mace race prej kafshërritësit (kultivuesit e maceve), duhet që të vizitohen shumë kafshërritës dhe të krahasohen kushtet, në të cilat janë rritur macet.
Kujdes me macet e dorëzuar me çmim të lirë: këto rrjedhin

shpesh nga një „prodhim masiv“ pa parakujdesje shëndetësore dhe nga mbajtja e papërshtatshme për mace, që shpien më vonë tek shumë probleme (shëndet i dëmtuar, të meta në tu sjellur)! Mënjanoni tërësisht blerjen e kafshëve përmes internetit! Ofertat e kafshëve përmes internetit shpesh kanë origjinën e prodhimit masiv dhe ato kultivohen në kushte të tmerrshme të mbajtjes. Gjithashtu edhe tregtia ilegale me kafshë bëhet përmes shpalljeve falas në internet, dhe mashtrimet janë po ashtu prezentë.

Çka ju nevojitet maceve?

Macet kanë nevojë dy herë në ditë për ushqim, macet e reja edhe më shpesh, dhe vazhdimisht ujë të freskët. Si mishngrënës të vërtetë, ato nuk mund të ushqehen vetëm me bimë e as me mbeturinat e ushqimit të njerëzve. Ka ushqime të ndryshme për kafshë që mund të blihen. Sheqeri i qumështit të lopëve shkakton barkqitje (diarre) dhe nuk është i përshtatshëm si ushqim për mace. Macet kanë nevojë gjithherë për telish që ti nxjerrin qimet e gëlltitura. Ena e ushqimit nuk duhet të qëndrojë pranë WC-së së maces. WC-ja e maces duhet çdo ditë 1-2 herë të pastrohet. Sipas legjislacionit zviceran për mbrojtjen e kafshëve, për çdo mace duhet të ofrohet një WC për mace, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për mace që qarkullojnë lire apo që mbahen në banesë. Ky legjislacion, gjithashtu parasheh mundësi për kruarje të maces (Trung druri për mace), vende të ndryshme për pushim dhe për tu fshehur, mundësi për ngjitje dhe ballafaqim për mace.

Kafshët e llojit të njëjtë

Macet sociale duhet të kenë mundësi për kontakt me macet tjera, macet e banesës për këtë arsye nuk bën te lihen vetëm. Kotelet (këlysh maceje) duhet të kenë mundësi të qëndrojnë të paktën 12 javë te nëna, te vëllezërit dhe te motrat. Kështu mësohen ato për jetën e mëvonshme dhe kanë më vonë edhe më pak te meta në të sjellurit. Legjislacioni zviceran për mbrojtjen e kafshëve parasheh për çdo mace që mbahet, së paku kontakt me shikim me mace të tjera, si dhe kontakt të mjaftueshëm me njerëz. Kotelet (macet e vogla) duhet të kenë mundësi të qëndrojnë të paktën 12 javë te nëna, te vëllezërit dhe te motrat e tyre.

Vendi i nevojshëm

Për macet e banesës duhet me qenë vazhdimisht në dispozicion së paku një dhomë për kafshë, prandaj në një banesë 3-dhomëshe nuk bën të jetojnë më shumë se 3 mace. Macet në lëvizje të lirë duhet të kenë mundësi gjithherë të hyjnë në shtëpi dhe jo të lihen jashtë.

Liri lëvizjeje ose mace për banesë?

Të dyja format e mbajtjes kanë të mirat dhe të metat: macet që lëvizin lirë në natyrë kanë një hapësirë jetike të larmishme, mirëpo ju nënshtrohen shumë rreziqeve, për shembull qarkullimit në trafik apo sëmundjeve. Macet për banesë duhet te mbahen në banesë prej vegjëlisë. Ato jetojnë më të parrezikuara (më gjatë se mesatarja e jetës së pritur) se macet që lëvizin të lirë në hapësirë, por synojnë më shumë drejtë çrregullimeve në sjellje. Banesa duhet me qenë e pajisur në përputhje me nevojat e maceve, mundësisht të ketë një dalje në ajër të pastër dhe diell mbi një ballkon të siguruar, dhe pronari duhet të jetë i dhënë pas kafshëve. Macet e banesës nuk bën të mbahen vetëm. Një dru gërvishtës, vendet e ngritura për shtrirje dhe soditje ashtu si vendpushimet e errëta dhe të buta dhe kutitë e thata prej kartoni si mundësi për tu fshehur dhe për të luajtur bëjnë pjesë në dekorin e kthinave. Macet duhet të kenë mundësi ti shfrytëzojnë dhomat në mënyrë tredimensionale. Kujdes: Ballkonet e pasiguruar dhe dritaret me hapje lartë-poshtë janë me rrezik jete!

Përkujdesja veterinare

Macet duhet të vaksinohen për çdo vit dhe t´ju hiqen krimbat shpesh. Veterineri gjegjësisht veterinerja bën vaksinimin e duhur dhe kështu kontrollon rregullisht edhe gjendjen shëndetësore të maceve.

Tredhja

Kujdesim përmes tredhjes është patjetër i nevojshëm, se macet përndryshe dy herë në vit lindin. Në Zvicër vriten pjesërisht në forme mizore çdo vit mbi 12 000 mace të padëshirueshme mbeten në strehimore të kafshëve dhe presin për një vend të ri. Macet e tredhura nuk trashen më shumë, nuk dembelosen më shumë, ato qëndrojnë gjahtarë të mira për minj, janë në përgjithësi më të shëndosha dhe një mace nuk bën të ketë pjellor para tredhjes. Tredhja në moshën 6 muajsh është ideale, te macet e rritura mes muajve nëntor dhe shkurt kur macet nuk janë as barrsë as kur s´thithin kotelet (këlyshët).

Macet dhe pushimet

Nëse është e mundur, macet duhet të qëndrojnë te shtëpia dhe të ushqehen dhe mirëmbahen prej një personi të specializuar dhe të besueshëm. Si alternativë ato edhe mund të strehohen në një pansion për kafshë ose në një strehimore të kafshëve, që kushton 15-35 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është i dënueshëm dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri 20 000 franga.

Macet dhe fëmijët

Macet mund të jenë për fëmijë partner dhe shokë të shkëlqyer. Prindërit janë më në fund përgjegjës për kafshë dhe duhet t´ju tregojnë fëmijëve, se si duhet të sillen me kafshët. Kafshët duhet të kenë mundësi që në çdo kohë të tërhiqen mbrapa nga fëmijët dhe nuk bën të shtrëngohen nga fëmijët. Fëmijët e vegjël dhe macet nuk bën të lihen vetëm.

Problemet në sjellje

Papastërtia, agresiviteti ndaj pronarit apo maceve të tjera, gërvishtje të padëshiruar dhe probleme të tjera në sjellje, nuk janë arsye për ti dërguar macet në strehimore të kafshëve. Specializant të kualifikuar të terapisë për sjellje dhe psikologë të kafshëve ju ndihmojnë pronarëve të maceve, gjatë e cilës ndihmë përshtatin mbajtjen me nevojat e maces dhe i trajtojnë në mënyrë terapeutike problemit në sjellje, me një shkallë suksesi deri 80 %. Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve (STS) ofron falas për pronarët e maceve këshillim psikologjik mbi kafshët.

Informacionet dhe vendet për kontakt

- Broshura: „Katzen“ (macet) (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), udhëzues i Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), mund të porositen falas me një zarf C5 të pajisur me pullë dhe të adresuar vetvetes. Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, Postfach, 4008 Basel, këshillim (gjermanisht, frëngjisht, anglisht) dhe porositje e materialit
  Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com, këshilla të përgjithshme falas, këshillim psikologjik i kafshëve në raste me probleme me macen (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), broshura falas, adresa të strehimoreve për kafshë, klubi i fëmijëve www.krax.ch.
- Broshura „Katzen – Tiere richtig halten“ (Mbajtja e duhur e maceve – kafshëve) (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), botuar nga Enti Federal për Veterinë BVET. Mund të porositet falas ose të shkarkohet në formatin PDF nga BVET, www.bvet.admin.ch dhe www.tiererichtighalten.ch

Redaktor:
Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com